



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 14/26
Me 26.01.2026
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG 02/Nr.69/25 e datës 10.11.2025, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal JUG me numër të protokollit 04.Nr.1590 e datës 26.01.2026 nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG AZHR Jug për periudhën janar 2026

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG AZHR kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-69-24 i datës 10.11.2025 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financoon projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 3,820.00 € sipas Raportit të Agjencisë për zhvillim Rajonal JUG e datës me numër të protokollit 04.Nr.1590 e datës 26.01.2026, pagesën e shumës për periudhën e muajit dhjetor 2026. Sipas bllokut kodues 10/626/48014/13460/00000/0411 dhe sipas numrit të zorimit 2026- 5129 e datës 24.01.2026.

Perfituesi	Nr. Përfituesit	Xhirrollogaria	Shuma
AZHR JUG	51121783	1705001600068752	3,820.00 €

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Për Zhvillim Ekonomik;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Palëve;
4. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniq

pe R. Mamushë





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 10 /26
Me 26.01.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG 02/Nr.69/25 e datës 10.11.2025, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal JUG me numër të protokollit 04.Nr.1589 e datës 26.01.2026 nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG AZHR Jug për periudhën dhjetor 2025

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal JUG AZHR kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-68-24 i datës 02.10.2024 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financo projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 3,820.00 € sipas Raportit të Agjencisë për zhvillim Rajonal JUG e datës me numër të protokollit 04.Nr.1589 e datës 26.01.2026, pagesën e shumës për periudhën e muajit dhjetor 2025. Sipas bllokut kodues 10/626/48014/13460/00000/0411 dhe sipas numrit të zorimit 2026- 5336 e datës 24.01.2026

Perfituesi	Nr. Përfituesit	Xhirrollogaria	Shuma
AZHR JUG	51121783	1705001600068752	3,820.00 €

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë Për Zhvillim Ekonomik;
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
3. Palëve;
4. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

[Signature]





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 09 -26
Me 22/01 -2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/1 -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës për aktivitetin e prokurimit “ Furnizim me Material Shpenzues Higjienik”
Komuna e Mamushës

NENI 1

Z. Yahya Šala Drejtor i Administratës së Përgjithshme dhe **Buyar Mazrek** Drejtor i Arsimit **Caktohen** persona përgjegjës nga njësitë Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës për aktivitetin e prokurimit “ *Furnizim me Material Shpenzues Higjienik*” **Komuna e Mamushës**

NENI 2

Personat përgjegjës sipas nenit 1 të këtij vendimi, kanë për detyrë që të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencës, duke u bazuar në Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

NENI 3

Obligohen- personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/ termat e referencës që në bazë të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores nr.002/2024 Për Plotësimin Dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin.

3.1. Deklaratë me të cilën deklaron se specifikimet teknike/ termat e referencës janë në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, që specifikimet teknike/ termat e referencës janë përgatitur në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

3.2. që Specifikimet teknike nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.

3.3 Obligohet personi përgjegjës që se bashku me Specifikimet teknike/ termat e referencës të plotësoj dhe të dorëzojë Deklaratën nën Betim, duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP.

NENI 4

Personi përgjegjës obligohet që ta dorëzoj specifikat teknike të hartuara tek Njësia Kërkuese me qëllim të Inicimit të Procedurës së Prokurimit.

NENI 5

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në përputhje me nenin 19 pika 19.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin, Njësia Kërkuese ka për obligim të caktojë një person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike apo termave të referencës për çdo aktivitet prokurimi.

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë dokumente kyçe për zhvillimin e një procedure transparente dhe efikase të prokurimit, të cilat duhet të përpilohen në pajtim të plotë me dispozitat ligjore, duke garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Përgatitja e saktë dhe e paanshme e këtyre dokumenteve është thelbësore për të shmangur konfliktet e interesit, si dhe për të siguruar suksesin e aktivitetit të prokurimit në të gjitha fazat e tij.

Në këtë drejtim, për të garantuar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe për të siguruar cilësi dhe përgjegjësi institucionale në hartimin e dokumentacionit të prokurimit, caktohet personi përgjegjës sipas dispozitave në vijim të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të caktuarit/a
2. Drejtorisë përkatëse.
3. Zyra e Prokurimit dhe
4. Arkiva.

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullah Krasnić





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 08/26
Me 19.01.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën e Mirëmbajtjes dhe Riparimit të Automjetit

Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik Kosova Motors J.S.C, sipas fletëpagesës nr. 95/26, e datës 16.01.2026 për servisin e rregullt të automjetit të tipit Ford Kuga, me targa 04Z-18-32 dhe numër të shasisë WFOFXXWPHPM23262.

Neni 2

Mjetet financiare që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria buxhetore “Mallra dhe Shërbime”, sipas përshkrimit “Mirëmbajtja dhe Riparimi i Automjetit Ford Kuga me targa 04Z-18-32 dhe numër të shasisë WFOFXXWPHPM23262”, në shumën 238.43 €, për përfituesin operatorin ekonomik Kosova Motors J.S.C, me numër unik të biznesit 811277591 dhe llogari bankare 1501120000296649.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Automjetet që janë në shfrytëzim nga institucionet komunale duhet të mirëmbahen rregullisht dhe t’u nënshtrohen riparimeve të nevojshme, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me qëllim të sigurimit të funksionalitetit teknik, sigurisë në komunikacion dhe përdorimit të rregullt institucional.

Automjeti i tipit Ford Kuga, me targa 04Z-18-32 dhe numër të shasisë WFOFXXWPHPM23262, është automjet zyrtar i Komunës së Mamushës dhe shfrytëzohet për nevoja institucionale. Gjatë përdorimit të rregullt, automjeti ka shfaqur nevojë për mirëmbajtje dhe riparim teknik, çka e bën të domosdoshëm realizimin e shërbimit përkatës nga një servis profesional dhe i autorizuar.

Komuna e Mamushës ka të lidhur kontratë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve zyrtare, në kuadër të së cilës automjeti në fjalë është i përfshirë në specifikacion. Megjithatë, automjeti Ford Kuga është blerë më datë 12.12.2023, dhe sipas nenit 4 të kontratës së shitblerjes, për të është paraparë garanci pesëvjeçare (5 vjet), e cila

përcakton qartë se të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes dhe servisimit gjatë periudhës së garancisë duhet të realizohen ekskluzivisht në servis të autorizuar nga prodhuesi.

Në bazë të kushteve kontraktuale të garancisë, në rast se servisimi i automjetit do të realizohej jashtë serviseve të autorizuar, automjeti do të humbiste të drejtën e mbulimit nga garancia, gjë që do të sillte pasoja financiare dhe juridike për Komunën e Mamushës. Për këtë arsye, edhe pse automjeti është i përfshirë në kontratën ekzistuese të mirëmbajtjes, servisimi konkret është realizuar në servis të autorizuar Ford, me qëllim të ruajtjes së vlefshmërisë së garancisë pesëvjeçare.

Servisimi dhe riparimi janë kryer në përputhje të plotë me kushtet e kontratës së shitblerjes, standardet teknike dhe rekomandimet e prodhuesit, duke garantuar funksionalitetin teknik, sigurinë në komunikacion dhe përdorimin e rregullt institucional të automjetit.

Andaj, duke pasur parasysh detyrimin kontraktual për servisimin në servis të autorizuar, domosdoshmërinë e mirëmbajtjes së rregullt të automjetit, funksionimin e pandërprerë të shërbimeve komunale si dhe interesin financiar të komunës për ruajtjen e garancisë, realizimi i pagesës për këtë shërbim është i arsyetuar, i ligjshëm dhe i domosdoshëm.

Për këto arsye, është marrë vendimi për lejimin e mjeteve financiare në shumën përkatëse, siç është përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtoria e Administratës
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniq





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

02 Nr. 07 -26

Me 12-01-2026

Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 lidhur me nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Shkresës së Zyrës së Kryeministrit me numër protokolli 02.Nr 01/26 datë 05.01.2026 si dhe në bazë të nenit 82 paragrafi 7 të Statutit të Komunës së Mamushës datë 01 12 2008 Kryetari i Komunës së Mamushës nxjerr këtë

V E N D I M

Për caktimin e Zyrtarit Përgjegjës për Raportimin e Pronave Publike

- I. Znj. Esra Osi me detyrë Udhëheqëse në DPUGJK me këtë vendim caktohet Zyrtar Përgjegjës për Raportimin e Pronave Publike nga Komuna e Mamushës pranë Zyrës së Kryeministrit lidhur me raportimin e të dhënave për pronat publike në Regjistrin Unik të Pronave Publike.
- II. Zyrtari i caktuar do të shërbejë si pikë zyrtare kontakti ndërmjet Komunës së Mamushës dhe Zyrës së Kryeministrit me qëllim të koordinimit përgatitjes dhe dorëzimit të të dhënave të sakta dhe të plota për pronat publike të Komunës së Mamushës.
- III. Detyrat dhe përgjegjësitë Zyrtari përgjegjës do të shërbejë si pikë kontakti ndërmjet Komunës së Mamushës dhe Zyrës së Kryeministrit me qëllim të raportimit të të dhënave për pronat publike Regjistri Unik i Pronave Publike detyrat do t'i zbatojë në bazë të Ligjit Nr 08 L 125 për Pronën Publike dhe me Rregulloren QRK Nr 04 2025 për Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës së Sendeve të Luajtshme dhe të Paluajtshme dhe Regjistrimin e Sendeve në Pronësi Publike Zyrtari përgjegjës do të bashkëpunojë ngushtë me zyrtarët përgjegjës të Zyrës së Kryeministrit për përfundimin e raportimit të të dhënave për pronat publike në Komunën e Mamushës më së largu deri me 31 mars 2026.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Znj. Esra Osi
2. ZKM
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës





02 Nr. 06 /26
Me 08.01.2026
Mamushë

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neneve 15 dhe 16 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenit 55 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, lidhur me nenin 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për hyrje në listë të pagave

Neni 1

Znj. Drenushe Shukaj, e cila sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës, përkatësisht nga Drejtoria Komunale e Arsimit, për pozitën Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze – Paralelen në Gjuhën Shqipe, është përzgjedhur fituese e konkursit në fjalë. Me datën 08.01.2026, e njëjta ka nënshkruar kontratë pune në kohë të caktuar, me numër protokolli 02.Nr.01-26, të datës 08.01.2026, me titull të pozitës Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze – Paralelen në Gjuhën Shqipe, në SH.F.M.U. “ANADOLU”.

Neni 2

Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që për të lartcekurën të përcjellë dokumentacionin përkatës tek Thesari i Kosovës – Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të përfshirjes së saj në listën e pagave, në bazë të kontratës së punës në kohë të caktuar me numër protokolli 02.Nr.01-26, të datës 08.01.2026, sipas legjislacionit në fuqi, me klasë page E19, koeficient 6.60, nga blloku kodues 10/626/93391/0912.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Znj. Drenushe Shukaj ka aplikuar në konkursin për pozitën Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze – Paralelen në Gjuhën Shqipe në SH.F.M.U. “ANADOLU”, i shpallur nga Komuna e Mamushës, përkatësisht Drejtoria Komunale e Arsimit, dhe pas procedurave të zhvilluara sipas legjislacionit në fuqi, e njëjta është përzgjedhur fituese e konkursit.

Angazhimi i znj. Drenushe Shukaj është me kontratë pune në kohë të caktuar, për shkak të nevojës për zëvendësim të përkohshëm të mësimdhënëses së rregullt, e cila ndodhet në pushim të lehonisë, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës dhe të drejtën në pushim të lehonisë.

Në këtë drejtim, me datën 08.01.2026, znj. Drenushe Shukaj ka nënshkruar kontratë pune në kohë të caktuar, me numër protokolli 02.Nr.01-26, për pozitën Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze – Paralelen në Gjuhën Shqipe në SH.F.M.U. "ANADOLU", kontratë e cila mbulon periudhën e mungesës së mësimdhënësës së rregullt gjatë pushimit të lehonisë.

Andaj, duke qenë se e njëjta ushtron detyrën mbi bazën e një kontrate të vlefshme pune në kohë të caktuar, dhe në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, krijohen kushtet ligjore që znj. Drenushe Shukaj të përfshihet në listën e pagave dhe t'i realizohen të drejtat financiare që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, për periudhën e angazhimit të saj si zëvendësuese.

Me këtë vendim njoftohet :

- DKA
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 05 /26
Me 08.01 /2026
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/I-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/I-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për hyrje në listë të pagave

Neni 1

z. Buyar Mazrek, me numër personal, **1232580611** është emëruar Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sportit në Komunën e Mamushës me vendim 02.Nr.03/26 e datës 08.01.2026 të Kryetarit të Komunës së Mamushës, i njëjti duhet të përfshihet në listën e pagave.

Neni 2

Obligohet- NjMBNJ që për të lartcekurin ta përcjellë dokumentacionin tek Thesari i Kosovës – Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të përfshirjes së tij në listë të pagave, sipas legjislacionit në fuqi, me klasën e pagës Y-23, koeficient 8.7, nga blloku kodues 10/626/94591/0922.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet :

- NjMBNJ
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 04/26
Datë : 08.01.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr-28/2008, neni 86 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe neni 71 i Ligjit nr. 08/l-197 Për Zyrat publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L294, neni 13 paragrafi 3 Ligjin nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/l-197 Për Zyrat publik, pas emërimit në bazë me numër të protokollit 02.Nr.03/26 e datës 08.01.2026 të marrë nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës me datë 08.01.2026 mer këtë:

V E N D I M PËR PEZULLIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Neni 1

Nëpunësi Publik **Buyar Mazrek**, i sistemuar në pozitën Mësimdhënës në Sh.M.L. “ATATÜRK” në Mamushë, pezullohet nga marrëdhënia e punës **pa kompensim të pagës**, për periudhën përkatëse të ushtrimit të funksionit publik si Drejtor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke filluar nga data **08.01.2026**.

Neni 2

Pas përfundimit të ushtrimit të funksionit publik, në pajtim me legjislacionin në fuqi, nëpunësi publik rikthehet në pozitën e tij të mëparshme të punës, përveçse në rastet kur merret vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A R S Y E T I M

Vendimi për pezullimin e marrëdhënies së punës për Nëpunësin Publik Buyar Mazrek merret pasi që i njëjti me vendim me numër të protokollit 02.Nr.03/26 e datës 08.01.2026 është emëruar Drejtor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Mamushës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrat Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L294 përcaktohet se nëpunësi pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet kur “ Emërohet në një nga funksionet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit” ndërsa neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 përcakton se “ përcakton se ky ligj nuk zbatohet

për funksionarët publik që janë të emëruar politik në nivel qendror dhe lokal, përjashtimisht pozitat e përcaktura në paragrafin 6 të nenit 5 të këtij ligji. Të njëjtat dispozita zbatohen edhe për nëpunësit e shërbimit publik sipas nenit 86 paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-294. Pas përfundimit të shërbimit publik, sipas këtij ligji, nëpunësi publik rikthehet në pozitën e mëparshme të punës.

Sipas nenit 13 paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtar Publik, Konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet nga “ Zyrтари më i lartë administrativ i institucionit ku nëpunësi ushtron detyrën detyrën.

Këshilla Juridike: Pala e Pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, prej ditës së pranimi të këtij vendimi. Ankesa i adresohet Komisionit për Ankesa në Komunën e Mamushës.

Me këtë njoftohet

- **Z. Buyar Mazrek**
- **DKA**
- **Arkiva**





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02 Nr. 04.26

Tarih: 08.01.2026

03/L-040 sayılı Yerel Yönetim Yasası'nın 13 ve 58'inci maddesinin (b) bendi, Kosova Cumhuriyeti Resmî Gazetesi'nin 28/2008 sayısında yayımlanan hükümleri ile 08/L-197 sayılı Kamu Görevlileri Yasası'nın 86'ncı maddesinin 2'nci fıkrası, 69'uncu maddesinin 1'inci fıkrasının 1.2 alt bendi ve 71'inci maddesi, 08/L-294 sayılı Kanun ile değiştirilen ve tamamlanan hükümleri ile, 08/L-294 sayılı Kamu Görevlileri Yasasında Değişiklik ve Tamamlamaya Dair Kanun'un 13'üncü maddesinin 3'üncü fıkrası uyarınca; Belediye Başkanından alınan 02.Nr.03/26 protokol numaralı ve 08.01.2026 tarihli atama kararı üzerine, Mamuša Belediye Başkanı, 08.01.2026 tarihinde aşağıdaki kararı almıştır:

K A R A R
İŞ İLİŞKİSİNİN ASKIYA ALINMASI HAKKINDA

Madde 1

Mamuša'da bulunan "ATATÜRK" Ortaöğretim Lisesinde Öğretmen olarak görev yapan Kamu Görevlisi Buyar Mazrek, Eğitim, Kültür, Gençlik ve Spor Müdürü olarak kamu görevini icra ettiği süre boyunca, 08.01.2026 tarihinden itibaren, ücret ödenmeksizin iş ilişkisinden askıya alınır.

Madde 2

Kamu görevini icra süresinin sona ermesinden sonra, yürürlükteki mevzuata uygun olarak, kamu görevlisi önceki görev pozisyonuna iade edilir; ancak kamu hizmeti ilişkisinin sona erdirilmesine dair bir karar alınması hâli bu durumun dışındadır.

Madde 3

Bu karar, Belediye Başkanı tarafından imzalandığı tarihte yürürlüğe girer.

G E R E K Ç E

Kamu Görevlisi Buyar Mazrek'in iş ilişkisinin askıya alınmasına ilişkin bu karar, kendisinin 02.Nr.03/26 protokol numaralı ve 08.01.2026 tarihli karar ile Mamuša Belediyesi Eğitim, Kültür, Gençlik ve Spor Müdürü olarak atanmış olması nedeniyle alınmıştır.

Bu bağlamda, 08/L-197 sayılı Kamu Görevlileri Yasası'nın, 08/L-294 sayılı Kanun ile değiştirilen ve tamamlanan 69'uncu maddesinin 1'inci fıkrasının 1.2 alt bendi uyarınca;

“Bu Kanunun 3’üncü maddesinin 1’inci fıkrasında belirtilen kamu görevlerinden birine atanması hâlinde, atanma süresi boyunca kamu görevlisinin resen askıya alınacağı” hükmü uygulanmaktadır.

Ayrıca, 3’üncü maddenin 1’inci fıkrasının 1.4 alt bendinde, bu Kanunun merkezî ve yerel düzeyde siyasi atama ile görevlendirilen kamu görevlilerine uygulanmayacağı, istisnai olarak 5’inci maddenin 6’ncı fıkrasında belirtilen pozisyonlar hariç tutulduğu açıkça düzenlenmiştir. Aynı hükümler, 08/L-197 sayılı Kamu Görevlileri Yasası’nın 86’ncı maddesinin 2’nci fıkrası uyarınca kamu hizmeti görevlileri için de uygulanmaktadır. Kamu hizmetinin sona ermesinden sonra, kamu görevlisi önceki görevine iade edilir.

08/L-294 sayılı Kamu Görevlileri Yasasında Değişiklik ve Tamamlamaya Dair Kanun’un 13’üncü maddesinin 3’üncü fıkrası uyarınca, askıya alma nedeninin tespiti, kamu görevlisinin görev yaptığı kurumun en üst idari amiri tarafından yapılır.

Hukuki Uyarı: Bu karardan memnun olmayan taraf, kararın tebliğinden itibaren 30 gün içerisinde, Mamuşa Belediyesi İtiraz Komisyonuna başvurarak itiraz etme hakkına sahiptir.

Bilgilendirilecektir:

- Sn. Buyar Mazrek
- **Belediye Eğitim Müdürlüğü (BEM)**
- Arşiv

Mamuşa Belediyesi Başkanı

Abdülhadi Kraniç



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02. Nr. 03-26

Datë: 08.01.2026

Kryetari i Komunës së Mamushës, duke u bazuar në nenet 13 dhe 58 lidhur me nenin 62 paragrafi 62.2 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin Neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushës 001/2008, me qëllim të emërimit të Drejtorit të Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini me datë 01.2026, Kryetari i Komunës mer këtë:

V E N D I M

- I. Z. Buyar Mazrek, emërohet Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mamushës.
- II. Kompensimi i pagës bëhet sipas Koeficientit 8.70 (klasa Y23) bazuar në Ligjin 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik)
- III. Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Mamushës janë të përcaktuara Ligjin 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Mamushës, si dhe me Ligje të tjera në fuqi dhe kryen detyra shtesë të caktura nga Kryetari i Komunës.
- IV. Drejtori është i obliguar ta bëjë deklarin e pasurisë, në përputhje me Ligjin 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.
- V. Emërimi i Drejtorit përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës apo me nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër nga Kryetari i Komunës.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Kryetar i Komunës së Mamushës

Abdullahi Krasniç

Me këtë vendim njoftohet :

- Z. Buyar Mazrek
- MAPL
- Zyra e Personelit dhe
- Arkivi



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



02. Nr. 03/26

Tarih: 08.01.2026

Mamuša Belediyesi Başkanı, 03/L-040 sayılı Yerel Yönetim Yasası'nın 13 ve 58'inci maddeleri ile 62. maddesinin 62.2 fıkrasına ve 001/2008 sayılı Mamuša Belediyesi Tüzüğü 82 maddesine dayanarak, Mamuša Belediyesi Eğitim, Kültür ve Gençlik Müdürlüğü Müdürünün atanması:

K A R A R

I. Sayın Buyar Mazrek, Mamuša Belediyesi Eğitim, Kültür ve Gençlik Müdürlüğüne Müdür olarak atanmıştır.

II. Ücret ödemesi, Kamu Sektöründe Ücretler Yasası 08/L-196 uyarınca Y23 sınıfı, katsayı 8.70'e göre yapılacaktır.

III. Mamuša Belediyesi Eğitim, Kültür ve Gençlik Müdürlüğü Müdürünün görev ve sorumlulukları, 03/L-040 sayılı Yerel Yönetim Yasasında, Mamuša Belediyesi Statüsünde ve yürürlükteki diğer yasalarda belirlenmiştir; ayrıca Belediye Başkanı tarafından verilen ek görevleri de yerine getirir.

IV. Müdür, 08/L-108 sayılı Malvarlığının Beyanı, Kaynağı ve Kontrolü ile Hediyeler Yasasına uygun olarak mal beyanında bulunmakla yükümlüdür.

V. Müdürün görevi, Belediye Başkanının görev süresinin sona ermesiyle veya Belediye Başkanı tarafından başka bir karar alınmasıyla sona erer.

VI. Bu karar, Belediye Başkanı tarafından imzalandığı anda yürürlüğe girer.

Bilgilendirilir:

- Sayın **Buyar Mazrek**
- Personel Ofisi
- Arşiv

Mamuša Belediyesi Başkanı


Abdülhadi Krasnić



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 02-26
Tarih/Dt. 08.01.2026	



02 Nr. 02 -26
Datë: 08.01/2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me Ligjin nr. 03/l-212 të Punës, Vendimi për Pushum të Lehonisë me numër te protokollit 02.Nr. 285/25 e datës 22.12.2026 dhe nenin 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M Për Ndalimin e pagës

Neni 1

Znj. Albana Iggji, e punësuar si Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze për paralelen në Gjuhën Shqipe në Sh.F.M.U. "ANADOLU" në Komunën e Mamushës, ka lindur më datë 22.12.2025 dhe, nga kjo datë, ka kaluar në pushim të lehonisë, çka është vërtetuar me dokumentacionin përkatës nga Spitali i Përgjithshëm "Dr. Daut Mustafa" në Prizren.

Neni 2

Punonjësja ka dorëzuar kërkesën për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë më 22.12.2025, pra pas datës 10 dhjetor, datë pas së cilës nuk lejohen ndryshime në listën e pagave për muajin dhjetor. Për këtë arsye, nuk ka qenë e mundur të përditësohej paga për muajin Dhjetor 2025 në sistem. Si rrjedhojë, paga për këtë muaj është ekzekutuar në vlerën e plotë, në vend të 70% të pagës bazë, siç parashikohet në nenin 49 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

Neni 3

Për pasojë, nga paga e muajit Janar 2026 duhet të kryhet një ndalesë në shumën prej 70.26 €, me qëllim që pagesa të harmonizohet me përqindjen që i takon punonjësës sipas legjislacionit në fuqi për pushimin e lehonisë.

Neni 4

Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë realizimin e ndalesës së përcaktuar në nenin 3 të tij.

Neni 5

Kjo ndalesë zbatohet vetëm për muajin Janar 2026, me qëllim të balancimit të pagës së muajit Dhjetor, gjatë të cilit paga është ekzekutuar në vlerën e plotë për shkak se lindja ka

ndodhur më datë 22.12.2025 dhe ndryshimet në listën e pagave mund të kryhen vetëm deri më datën 10 të çdo muaji. Pas këtij muaji, paga e punonjësës do të vazhdojë të ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht në nivelin e 70% të pagës bazë për periudhën e mbetur të pushimit të lehonisë.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Znj. Albana Iggji ka sjellë në jetë fëmijën e saj më datë 22.12.2025 dhe, në të njëjtën ditë, ka parashtruar kërkesën për shfrytëzimin e pushimit të lehonisë, i cili ka filluar nga data e lindjes së fëmijës.

Për shkak se procedurat administrative për përditësimin e listës së pagave mund të kryhen vetëm deri më datën 10 të çdo muaji, dhe lindja ka ndodhur pas kësaj date, nuk ka qenë e mundur të përditësohet statusi i punonjësës për muajin Dhjetor 2025. Si pasojë, paga për këtë muaj është ekzekutuar në vlerën e plotë, ndonëse, sipas legjislacionit për pushimin e lehonisë, punonjësës i takon pagesa prej 70% të pagës bazë.

Duke u bazuar në rishikimin e të dhënave, zbatimin e dispozitave të Ligjit të Punës dhe detyrimin për harmonizimin e pagesave me periudhën aktuale të pushimit të lehonisë, është e nevojshme që tejpagimi i realizuar për muajin Dhjetor të korrigjohet. Kjo do të bëhet përmes ndalesës në shumën prej 70.26 € nga paga e muajit Janar 2026, duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe rregullat financiare në fuqi që rregullojnë kompensimet dhe balancimet në raste të tilla.

Pas muajit Janar 2026, paga e punonjësës do të vazhdojë të ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht 70% e pagës bazë për periudhën e mbetur të pushimit të lehonisë.

Njoftohen

- DKA
- Thesari-MFPT
- Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdühadi Krasniç





Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 01 /26
Me 05.01.2026
Mamushë



Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 15 dhe 16 i Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, neni 55 i Ligjit nr. 03/L-212 i Punës lidhur me nenin 44 dhe 46 Ligji nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë 01/2008 të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës së Mamushës merr këtë:

V E N D I M
Për hyrje në listë të pagave

Neni 1

znj. Neshe Morina me numër personal: 2173602947, e cila sipas konkursit të shpallur nga Komuna e Mamushës me titull të pozitës Zyrtare për Shpenzime të Buxhetit me numër të referencës: RN00018864 është përzgjedhur si fituese e konkursit në fjalë dhe me datën 05.01.2026 ka nënshkruar Aktemërimin e punës me numër të protokollit 02.Nr.001/26 e datës 05.01.2026, me titull të pozitës Zyrtare për Shpenzime të Buxhetit, kategoria Profesional 2, klasa GJ40 koeficienti 5.75.

Neni 2

Obligohet- Njësia e Burimeve Njerëzore që për të lartcekurin ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të hyrjes në listë të pagave në bazë të Aktemërimin e punës me numër të protokollit 02.Nr.001/26 e datës 05.01.2026.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

znj. Neshe Morina me numër personal: 2173602947, ka aplikuar në konkursin publik për pozitën “Zyrtare për Shpenzime të Buxhetit” të shpallur nga organi kompetent. Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit dhe vlerësimit, është shpallur fituese e këtij konkursi.

Në përputhje me këtë, me datën 05.01.2026, ka nënshkruar Aktemërimin e Punës, me numër protokollit 02.Nr.001/26 e datës 05.01.2026, për ushtrimin e detyrave në pozitën Zyrtare për Shpenzime të Buxhetit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dhe duke marrë parasysh se znj. Neshe Morina e ka filluar zyrtarisht marrëdhënien e punës, dhe duhet të përfshihet në listën e pagave, sipas pozitës së caktuar dhe koeficientit përkatës.

Me këtë vendim njoftohet :

- NJMBNJ
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

